

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot më datë 24/05/2021 (dymijë e njëzetë) prane zyres se Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k u paraqiten palet e meposhtme, te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

PALA SHITËSE: OMID KARIMI, lindur me 10.07.1983, ne Teheran, shtetas Afgan, banues ne Tirane, indetifikuar me Pasaporte nr. OA1411685, madhor me zotesi te plote per te vepruar , pajisur me leje qendrimi shqiptare nr.3760, njohes i gjuhes shqipe , në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi");

PALA BLERËSE: ELTON IBRALIU atesia Misir , i lindur më 10.12.1974 ne Fier dhe banues në Tiranë madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar i identifikuar me letërnjoftimin nr.personal H41210017R , (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

Kushtet paraprake

- A) Shitësi është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 100% (njqind përçind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS NUIS L62221018T, me seli ne TIRANE ,Rruga "Pese Maji", Vila L, Shkalla 1, Ap.26, Shqipëri (në vijim referuar edhe si "Shoqëria")
- B) Blerësi z. ELTON IBRALIU dëshiron të blejë nga Shitësi 1 (nje) Kuotë e barabartë me 100% (njqind përçind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.
- C) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1 (nje) kuote e barabartë me 100% (njqind përçind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- D) Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët e Shoqërisë janë njoftuar për shitjen e Kuotës sipas dispozitave të statutit.
- E) Më datë 24./05/2021 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotës sipas vendimit bashkengjitur kesaj kontrate.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1


Kushtet paraprake

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore të kësaj Kontrate.

Neni 2

Shitja e kuotës

- 2.1. Njëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi bie dakort te shese, transferoje dhe dorzoje 1 (nje) kuote e barabarte me 100% (njqind përçind) te kapitalit themeltar qe ai zoterton ne shoqerine "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 2.2. Shitja dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejttat dhe detyrimet e shitesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme. Palet bihen dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate.



2.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" shpk do të jetë:

1. ELTON IBRALIU zotërues i 1 (një) kuote në pjesëmarrje në përqindje 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k.

Neni 3

Çmimi

Çmimi i shitjes së pasurisë objekt i kësaj kontrate shite do të jetë sa vlera e kapitalit themeltar të kuotes dhe konkretisht në vlerën 200 000 (dyqind mijë) leke të reja të cilat janë paguar nga pala blerëse në favor të pales shitesë para nënshkrimit të kësaj kontrate sipas mandatit bashkëngjitur kësaj kontrate.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

4.1 Shitësi garanton Blerësin se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.

4.2 Shitësi garanton Blerësin se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng,, privilegj, barrë, e drejtë parabolje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

4.3 Blerësi deklaron se blen Kuotën e Shitësit, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.4 Shitësi me nënshkrimin e kësaj kontrates nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje me 1 (kuote) e barazvlefshme me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k që ai zotëronte, dhe pronar i vetëm dhe legjitim pa asnjë barrë dhe detyrim ndaj të tretëve behet blerësi z. ELTON IBRALIU.

4.5 Kjo kontrate do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj paleve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt.

Neni 5

Shpenzimet dhe taksat

5.1 Shpenzimet ligjore dhe taksat, shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të Blerësit.

5.2 Shpenzimet e tjera do të paguheshin nga palet sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6-Interpretimi i kontratës

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti.

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nese pjesë të kësaj kontrate janë ose behen të pavlefshme ose jodetyruese, palet do të jenë të detyruara të zbatojnë pjesën tjetër të kontratës, Në këtë rast, palet do të zvendesojnë pjesën e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese efektet e të cilave sipas përmbajtjes dhe qëllimeve të kësaj kontrate duhet të jenë në kufijtë e të mundshmes, e ngjashme me pjesën e pavlefshme ose jodetyruese.


NENI 7- Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 8

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.



Neni 9

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 100 % (njqind përqind) të kapitalit themeltar që zoteron shitësi, tek Blerësi dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklaratimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 10

Anekset e kontrates

Kesaj kontrate i bashkëngjiten si pjesë perberese dhe te pandara keto dokumenta që do të quhen Aneke të kontrates. Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkëngjitur:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar
- Kopje të letërnjoftimeve të personave nënshkrues
- Vendimi i Asamblese së Përgjithshme.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

PALA SHITËSE
OMID KARIMI



PALA BLERËSE
ELTON IBRALIU





Data : 24-05-2021

Dega: 022-Dega Bulevardi Zogu i I
Arka/Nr: VSP-0025
Veprimi: 20210524Vjola.Spaho02240832
Ref:

Depozitim Per te Trete

Urdhënesi: ELTON MISIR IBRALIU
Perfituesi: OMID AHMAD KARIMI
Nr Llogarise: 0001225300
Komision: ALL 125.00
Totali Ne Llogari: ALL 200,000.00
Shuma e Klientit: ALL 200,125.00
Kursi: 1.00

Pershkrimi: ELTON IBRALIU,DERDHI PAGESE PERSHIT-BLERJEKUOTASHI
Veprimi:

Sasia	Prerjet	Vlera	
40	5,000.00	200000.00	
1	200.00	200.00	
1	50.00	-50.00	Kusur
2	10.00	-20.00	Kusur
1	5.00	-5.00	Kusur
Totali:		200,125.00	



Arkëtari

Vjola Spaho

Klienti

Elton Ibraliu
Elton Ibraliu

Rifreskoni kontaktet tuaja!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products and services, and other.